

BIBLIOTEKA
SHTETIT


814-32

P 71

**PJESE
NGA PROZA
JONE E
TRADITES**

8JK-32
PF

PJESË NGA PROZA
JONË E TRADITËS



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

H Y R J E

Në ditët tona, sa vjen e më shumë po ndiehet nevoja e ribotimit të autorëve më të mirë të së kaluarës, në mënyrë që masa e gjerë e lexuesve të njihet më mirë me traditat e shëndosha të letërsisë sonë dhe nga ana tjetër, të jetë në gjendje të vlerësojë më drejt hapin e madh që ka bërë letërsia jonë gjatë vjetëve të pushtetit popullor, duke ecur në rrugën e realizmit socialist.

Prandaj mendojmë se kjo antologji e prozës shqipe të paraqitimit, do të plotësojë sado pak këtë nevojë.

Në vështrim të parë duket sikur një vëllim kaq i vogël si ky nuk mund të përfaqësojë gjithë ç'ka më të mirë proza jonë e paraqitimit që nga fillimet e saj e deri në kohën e Luftës nacionalçlirimtare.

Por nuk duhet të harrojmë se në letërsinë shqiptare proza artistike është lëvruar shumë më pak se sa poezia, për disa arsye të njohura.

Gjatë Rilindjes, letërsia në radhë të parë, pati misionin e lartë që të ngjallte ndjenjat patriotike në masat e gjera të popullit dhe t'i frymëzonte ato në luftën çlirimtare kundër pushtuesit turk. E një mision të tillë mund ta kryente, siç e kreu, shumë më shpejt poezia se sa proza.

Kjo gjë bëri që deri në shpalljen e pavarësisë të kemi fort pak prozë artistike.

Kurse gjatë periudhës 1912-1939 përkrah poezisë vëmë re një farë lulëzimi të prozës sonë.

Nga ana tjetër duhet vënë në dukje se populli ynë ka një shpirt poetik. Kjo gjë duket edhe në krijimtarinë gojore të tij. Ai historinë e vet e ka përjetësuar në

këngët, që të mahnisin për bukurinë dhe sintezën e tyre.

Jo rastësisht, figurat më të mëdha të letërsisë shqiptare të së kaluarës janë poetët: Naim Frashëri, Jeronim De Rada, Andon Z. Çajupi, Gavril Dara, Zef Serembe, Mjeda, Asdreni, Noli etj.

Në këtë antologji, nga disa autorë është futur edhe ndonjë shkrim gazetaresk (publicistik). Këto shkrime i zgjodhëm jo vetëm sepse kanë një përmbajtje të shëndoshë patriotike, por edhe për vlerën e tyre artistike.

Autorët e antologjisë janë përpjekur që të fusin këtu vetëm shkrimet më të mira në prozë, duke u nisur si nga përmbajtja dhe nga forma, e duke parë që ato të kenë një vlerë aktuale.

Me qenë se kjo antologji do të shfrytëzohet nga të gjitha shtresat e lexuesve, me arësim dhe moshë të ndryshme, brenda saj janë bërë pak shënime sqaruese.

Lidhur me ortografinë janë bërë disa ndryshime për t'i sjellë në ortografinë e sotme krijimet e përmbledhura në këtë antologji, por, me qëllim që të lehtësohet leximi dhe të arrihet një ortografi unike, shumë rrallë është prekur ndonjë formë gramatikore që sillte vështirësi kuptimi.

F. HAXHIAJ

TH. GJIKÀ

MBI RRETHIMIN E PARË TË SHKODRËS (1474)¹⁾

(Pasi autori më parë ka kujtuar lavditë e vjetra të qytetit të vet, duke hyrë në tregimin e ngjarjeve të fundit, thotë:)

Do të dalë ndokush të më thotë: këto janë punë të vjetra. . .

Po, le t'i quajmë të vjetëruara ato që përmendëm, le të jenë vyshkur e tharë, le të jenë bërë hi e pluhur. Po, çfarë do të themi për këto ngjarjet e freskëta që i kemi parë me këta sy në rininë tonë? Të flas apo të qëndroj në heshtje?

Se me çfarë bese e qëndrese, në mesin e dallgëve të fatit, shkodranët e patën duruar atë luftë aq të gjatë, një nga më të rëndat e më të rrezikëshmet që u pati shkaktuar Mehmeti, ai tirani më mizor i turqve, këtë të gjithë e dinë më së miri, të gjithë e dinë se si Sulejman Pasha me njëqindmijë ushtarë të grumbulluar nga krahinat e Evropës dhe nga vetë hordhitë e tiranit, e pati rrethuar Shkodrën: se si i pat rafshuar përdhe muret e qytetit dhe ndërtesat publike e private, se si, ku me kërcënime e ku me premtime, i pati ftuar qytetarët që të dorëzoheshin, se si qyteti im e pati pritur trimërisht gjithë atë mori ushtrie pikërisht te muret e veta; pikërisht atje sa e sa herë i dërmoi, bëri kërdi të

1) Fragmente marrë nga një ligjëratë e Beçikemit, ku ai flet për heroizmin e bashkatdhetarëve të tij.

Marin Beçikemi qe humanist i shquar shkodran. U dallua për diturinë dhe oratorinë e tij. La shumë vepra latinisht me brendi letrare dhe shumë ligjërata.

madhe dhe iu vu në shpinë jenjçerëve, të cilët lëshoheshin rrëmujë nëpër kufoma të shokëve të tyre, deri rrëzë kodrës. Të gjithë e dinë se si qyteti i im shtiu në dorë flamujt ushtarakë dhe plaçkat e një triumfi të mrekullueshëm; se si prapsoi dhe thuajse i dërmoi me plagë nja njëzetmijë veta të armikut sëbashku me tridhjetë komandantë, ndër të cilët ishte edhe Ali beu, pasha i Serbisë. . .

Flamujt e armikut njëmijë herë u ngritën majë ledheve; u zhvilluan përleshje fytyfyt edhe në zemër të qytetit; asnjë qytetar, çfarëdo shkalle, nuk mbeti pa marrë një plagë. Orvatej babai t'u jepte zemër djemve, vëllai vëllait, qytetari qytetarit dhe duke kaluar nëpër kufomat e të vetëvet, turreshin mbi armikun.

Edhe vajzat e gratë s'ua lëshonin vendin burrave për trimëri. Shihje djalin që po mbaronte aty në prani të nënës, burrin ndër sy të gruas, vëllain të shtrirë për-dhe përmbri motrës, dhe gjithnjë ato nuk i drejtonin sytë aty, por vazhdonin t'u përgatishnin luftëtarëve më të fortë armët për t'i përdorur kundër armikut, kryenin çdo punë që u ngarkonin, zevendësonin në shumë punë luftëtarët që pushonin për pak kohë ose që do të lidhnin plagët. As topi, as arma, as plaga, as vdekja s'frikësonte njeri; të gjithë ishin të vendosur për një qëllim: të shpëtonin qytetin, duke derdhur gjakun deri në pikën e fundit. Në të katër anët mbretëronte kërdia e zezë, kudo shihej vdekja me sy: shihje qytetarë të bërë copë-copë prej topash, trupa të tërë që hidheshin në erë, mure, rrugica, rruga, sheshe, ndërtesa të pëlyera me gjak, me copa mishi e me zorrë të copëtuara; nga çdo anë rridhte gjaku si përrua.

Në fund, kur, pas marrëveshjes që u përfundua, atdheu fatzi ra në dorën e armikut, shkodranët e braktisën atë tokë të bekuar, ku ishin lindur e rritur; ata lanë aty faltore e vorreza, vatra e shtëpi, tokë aq pjellore e të bukura, lanë aty thuajse të gjithë pasuritë.

Ja një vepër e mrekullueshme që duhet të kujtohet sa të jetë jeta. . . asnjëri nuk u gjet, megjithëse të ftuar publikisht dhe privatisht, dhe ndonëse shumë

veca u tërhoqën me premtime e dhurata prej barbarit, asnjë, po them, nuk u gjet që të mos pranonte më parë ta çonte jetën në mërgim të zi, i mjeruar, i shkretuar, i varfëruar... se sa të qendronin në mes të pasurive dhe të të mirave të atdheut të dashur, por duke e thyer në një mënyrë ose në një tjetër besën e dikurshme të dheut të Shkodrës.

Kur armiqtë, megjithëse armiq dhe armiq të vërtetë e të pashpirtë, panë grumbullimin e aytetarëve që në heshtje të zymtë po merrnin rrugën e mërgimit, ashtu edhe gjendjen e mjerueshme të grave shkodrane të cilat, përmes radhëve barbare, tërhiqnin si shokë mërgimi fëmijët e vet që vajtonin, s'patën se si të mos çuditeshin për atë besë e qëndresë dhe të mos i mbanin lotët.

HISTORIA E SKËNDERBEUT²⁾

.....

Kastrioti, fort krenar për këtë simpati nga të tijtë, në kohën, kur të gjithë i kishte radhitur për luftë dhe ishte gati për t'u nisur, thuhet se, duke u këshilluar për mënyrën se si duhej vepruar dhe duke nxitur ushtarët, mbajti këtë fjalë, para se të jepte urdhërin e nisjes:

«Asgjë të re, as të papritur nuk shoh këtu, kapedanë dhe ushtarë kryetrima, që të mos ma ndjente më parë zemra dhe të mos më mbushte me shpresë, sa herë që unë sillja ndër mend tërë mall edhe bujarinë e lashtë të popullit, edhe shërbimet e veçanta dhe zyrtare tuaja ndaj babës tim, Gjonit. Dhe me të vërtetë, mos ma merrni për mburrje, por unë s'kam dyshuar kurrë, në asnjë çast të jetës sime, se, kur ruanja në zemër këtë qëllim, këtë dashuri për atdhe, kur ushqenja këto ndjenja për liri, këto dëshira të mira, që s'më ndaheshin, ishin edhe tuajat. Kur ju më ftonit shpesh, në kohën që isha pranë Tiranit, me tërë dashurinë dhe gatishmërinë tuaj për këtë vepër, gjë që unë tani e kujtoj me kënaqësi dhe e them me mburrje, ju shkonte ndoshta në mend se e kisha harruar atdhenë, se e kisha harruar nderin tim dhe lirinë, meqë ju kthenja prapë në shtëpi fort të pikëlluar, pa asnjë shpresë të sigurtë, pa asnjë shënjë të qartë të qëllimit tim. Po s'ka dyshim, qy-

1) Historiani i parë i popullit tonë, një nga humanistët më të shquar të shekullit XV. Lindi aty nga viti 1450 dhe vdiq pas vitit 1512.

2) Fragmente marrë nga vepra kryesore e Barletit «Historia e Skënderbeut» Botimi: Tiranë 1967.

tetarë, se me atë heshtje time, me atë përlësi të shtime të shpirtit tim, unë mendonja për vehte dhe për ju, sepse punët ishin t'atilla, që duheshin bërë më tepër se sa thënë, kurse ju kishit nevojë më fort për fre se sa për mamuza. Po e them se unë ua fsheha planet e mia, se s'ju thashë asnjë fjalë gjatë gjithë asaj kohe për dëshirat e mia, jo sepse dyshonja në besnikërinë tuaj apo s'jua dinja mirë shpirtin, pora ju vetë m'i çfaqët të parët qëllimet tuaja në atë kohë aqë të rrezikshme, por sepse më mbante frika që më shtinte brishtësia e vdekëtarëvet dhe papërmbajtëshmëria e njerëzvet, e cila lëshohet me ngut në çdo punë dhe, kur është rasti për lirinë, rrëmbehet e s'bëhet dot zap, nuk peshon asgjë, nuk ia var asnjë rregulli. Dhe, sikur t'i paraqitet rasti më i vogël jo vetëm për ta fituar, por për ta provuar lirinë, atëhere s'mund ta largojnë atë nga qëllimi as një mijë shpata, siç i thonë një fjale, as një mijë rreziqe, as vdekja e sigurtë dhe as rreziku i padëshimtë i të miravet dhe i jetës.

Por, kur në një punë të tillë, të nisur kot, përpjekjet dalin pa gjë, atëhere s'mbetet veçse vdekja më mirë apo skllavëria edhe më e keqe, dhe çdo shpresë për të nesërmen fluturon e rasti, që të shket një herë nga duart, s'kthehet më kurrë prapë. Kjo punë nisët një herë e mirë e. në mos vafhtë mbarë, mundësia çduket përgjithmonë. Prandaj unë, po jua them sheshit, nuk e shikonja as vehten time si një pjesëtar të sigurtë në këtë plan. Kisha frikë se mos gjuha, që s'i durohej para një pune kaqë të madhe, se mos muret e shtëpisë më tradhëtonin. Për dëshmitar kam Hamzanë, nipin, që u bë pastaj përkrahësi kryesor i planit, dhe shoku i mundit, si dhe disa të tjerë fare të pakë, me ndihmën besnike dhe të papërtuar të të cilëvet jemi duke e kryer këtë punë. Dhe, sadoqë neve na qëlloi të jetonim bashkë, të ushqeheshim dhe sidomos të kishim një shpirt e një zemër, megjithëkëtë asnjë nga këta s'më mori vesh që unë s'e kisha harruar atdhenë, veçse në luftën hungareze, asnjë s'ma dëgjoi zërin, të flisnja si njeri i krishterë e i lirë, veç se atëhere, kur e pati mundësinë pa frikë ndëshkimi.

Ju, epirotët, mund të gjenit një tjetër mbrojtës të lirisë, një tjetër përkryes të qëllimevet dhe të aspiratave tuaja, sepse në këtë vënd s'kanë munguar mëndjet e ndritura; po juve ju pëlqeu megjithëkëtë, se ndoshta kështu e deshën perënditë, që këtë liri ta prisnit më mirë nga unë, qoftë edhe vonë, se sa nga të tjerë, apo ta fitonit vetë me dorën tuaj. Ju, si burra aqë të fortë, të rritur në liri, që qëndruat kaqë kohë në mynzyrën barbare, nuk u mërzitët gjersa të më shihnit. Por përse doni që unë ta mbaj për vehte me të padrejtë emrin e çlirimtarit? Lirinë nuk e solla unë, por e gjeta këtu. Sapo më shkeli këmba truallin tuaj, sapo dëgjuat emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, më duallët përpara kush e kush më parë, sikur të kishit dëgjuar se u ngritën nga varret etërit, vëllezërit, bijtë tuaj, sikur të kishin zbritur këtu gjithë perënditë. Ju më latë prapa, ju m'i lidhët menjëherë duart, ju më mbytët me shërbime aqë të mbëdha dhe me një gaz shpirtor aqë të madh, sa që duket se ju më kini bërë tani aq rob, sa edhe të lirë. Mbretërinë dhe këtë qytet nuk jua dhashë unë, po ju ma dorëzuar mua. Armët nuk jua solla unë, por ju gjeta të armatosur. Lirinë e pashë se e kini kudo, në kraharor, në ballë, në shpatat e në ushtat...

.....

... Por a mund të ketë lavdi më të madhe, a mund të ketë shpërblime më të mëdha për cilindo nga ju se sa shpëtimi i atdheut, që varet nga dora e ju të gjithëve? Peshojeni, pra, mirë, o burra kryetrima, se ç'rëndësi të madhe ka puna juaj sot. Po u mundëm në këtë betejë, e kemi të humbur gjithë luftën; po duallëm përkundrazi fitimtarë, do ta heqim qafe zgjedhën e tanishme të Muratit, do të kujdesemi, në të ardhmen, vetëm për paqen dhe qetësinë e përherëshme. Silleni ndër mënd zgjedhën armike, talljet e mundësit dhe pamjen tërë mburrje të tij; sillni ndërmënd edhe se ç'mizëri njerëzish të ndryshëm na përcollën, kur u nisëm e u larguam nga sytë e tanëvet, se me ç'dëshira